

VENDIM
Nr.1630, datë 17.12.2008

**PËR SHTYRJEN E AFATIT TË BOTIMIT TË NJOFTIMIT TË FITUESIT DHE TË
NJOFTIMIT TË KONTRATËS SË LIDHUR, PËR PROCEDURËN E PROKURIMIT, TË
KRYER NGA KËSHILLI I QARKUT TË ELBASANIT, SI AUTORITET
KONTRAKTOR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 75 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e këshillit të qarkut të Elbasanit ta shtyjë afatin e botimit të njoftimit të fituesit dhe të njoftimit të kontratës së lidhur, deri më 23.12.2008, për procedurën e prokurimit, për fondin 2 833 333 (dy milionë e tetëqind e tridhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre) lekë, të parashikuar në buxhetin e vitit 2008, për objektin “Hartimi i detyrës së projektimit dhe hartimi i planit të përgjithshëm rregullues të Fushë Studen, në komunën Steblevë, të qarkut të Elbasanit”. Për këtë objekt vlera e paradhënies të jetë në masën 10 për qind.

2. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Ministria e Financave, Agjencia e Prokurimit Publik dhe këshilli i qarkut të Elbasanit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha